

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti Për Krimeve Të Rënda, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit I. M., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375/1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/Inr.372/16 të dt.09.09.2016, pas shqyrtimit fillestar me datë 27.12.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: I. M., i biri i R., dhe B., e gjinisë P., i lindur me dt. *data e lindjes...*, me numër personal *numër personal...*, me vendbanim në P., M. II, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i punësuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 27.07.2016, rreth orës 00:20 në Prishtinë në Lagjen Mati II, në shtëpinë e tij familjare, kur daja i tij R. P. është parkuar me automjet në bari në oborrin e shtëpisë të të pandehurit, nën ndikimin e alkoolit (në orën 02:00 ka pasur 1.15 promil alkool në organizëm), i pandehuri ka përdorur armë zjarri duke shkrepur 6 fishekë në ajër nga pistoleta e armës “Crevna Zastava” të kalibrit 7.65 mm, me numër serik 42441 e prodhimit Jugosllav të cilën i pandehuri e ka mbajtur dhe përdorur duke shkelur dispozitat Ligjore për armë, e cila pistoletë së bashku me 1 karikator, 7 fishek të kalibrit 7.65 mm, dhe 6 gëzhoja të kalibrit 7.65 mm të gjetura në vendin e ngjarjes janë konfiskuar përkohësisht nga Policia.

- Me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375/1 të KPRK-së

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,43,45,50,51,52,73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK –së, e gjykon:

DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit I. M., i caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën prej 2 (dy) vite.

Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedure penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 euro, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komfor nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPK-së konfiskohet:

Revolja e tipit Cërvena Zastava me numër serik 42441, 1 karikator, 7 fishekë të kalibrit 7.65, dhe 6 gëzhoja 7.65 mm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.372/2016, të datë 09.09.2016, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin I. M., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375/1 të KPRK-së.

Me datë 27.12.2016, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë qështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PP/I.nr.372/2016, të datë 09.09.2016, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykes pas qe u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri I. M., në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i është vënë në barrë, duke shtuar se veprën e kishte kryer ngase në natën kritike ishte në ndikimin e alkoolit, dhe ka shfaqur pendesën për veprën e kryer, po ashtu i ka premtuar Gjykatës se më nuk do të bie ndesh me ligjin.

Prokurori i shtetit pas deklarimit të të pandehurit, deklarojë se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit I. M., që është ngarkuar sipas akuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti i Krimeve të Rënda PPI.nr 372/2016 e dt 09.09.2016, për veprën penale Përdorimi I Armës apo Mjetit të Rrezikshëm nga neni 375/1 të KPRK-së, duke i propozuar Gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit, ndërsa me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit të ketë parasysh të gjitha provat e propozuara në aktakuzë nga ana e Prokurorisë të cilat e inkriminojnë të akuzuarin, si dhe rrethanat e tjera të cilat e lehtësojnë pozitën e të akuzuari, siç është pranimi I fajësisë, rrethanat në të cilat e ka kryer veprën penale, si dhe faktin që më herët i njëjti nuk ka qenë në ndesh me ligjin.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza siç janë: foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes për armën e konfiskuar, vërtetimi për konfiskimin e armës i dt. 27.07.2016, aktvendimi për fillimin e hetimeve i dt. 05.09.2016, deklarata e të pandehurit dhënë në prokurori me dt. 06.09.2016, si dhe dokumentacioni tjetër që gjendet në shkresat e lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, rrethanat e tij familjare, i njëjti është i martuar baba i dy fëmijëve, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim burgimi me kusht si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cila është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komfor nenit 115 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. nr.548/16, datë 27.12.2016

Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.